

VENDIM
Nr.982, datë 1.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
“RRUGA TRANSBALLKANIKE, VLORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit “Ruga transballkanike, Vlorë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2 818 (dy mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) m², tokë truall, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 33 816 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 242 000 (dyqind e dyzet e dy mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 33 816 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.12.2010 dhe të përfundojë më 15.4.2011.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, për të gjithë segmentin “Ruga transballkanike, Vlorë” dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara me këtë vendim, si dhe vendimet nr.857, datë 29.11.2007, nr.1194, datë 3.12.2010 e nr.62, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin që të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE, PASURITË NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA

RRUGA “TRANSBALLKANIKE”, VLORE

Lloji i pasurisë së patundshme: truall

Nr.	Pronari	Nr.Pas.	Z.K.	Truall			Shënime
				Sip. (m ²)	Çmimi lekë m ²	Vlefta në lekë	
1	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/114	8605	428	12000	5 136 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/119	8605	837	12000	1 004 4000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/5	8605	174	12000	2 088 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/62	8605	246	12000	2 952 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/40	8605	889	12000	10 668 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/10	8605	135	12000	1 620 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/11	8605	109	12000	1 308 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
	Totali			2 818		33 816 000	